



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/ 2018

V E N D I M

Nr. 44 , Datë 07 / 02 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr. regj.17, datë 31.01.2018, të z.K. B, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrisë së Shëndetësisë, me pretendimin e diskriminimit “*për shkak të gjendjes shëndetësore*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I :

Z.K. B, në ankesën e tij informon Komisionerin lidhur me situatën e vëllait të tij, z.A. B. Ai citon se, z.A. B, në vitin 1976 ka pësuar një dëmtim fizik në ambjentet e punës, në kantierin e ndërtimit dhe si pasojë e këtij dëmtimi është ekzaminuar me diagnozën “Skizofreni”. Ai është kurrar në ambjentet e spitalit dhe në shtëpi për vite me radhë. Në vitin 2000 ka dhunuar fizikisht nënën e tij, duke rrezikuar seriozisht jetën e saj. Lidhur me këtë ngjarje ai është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Fier, në vitin 2001 e cila në përfundim të gjykimit ka dalë me vendim pushimi të gjykimit të çështjes penale dhe ka urdhëruar shtrimin e tij për mjekim të detyrueshëm në Spitalin Psikiatrik të Tiranës. Pavarësisht urdhërimit të gjykatës, z.K. B shprehet se ky vendim nuk u zbatua dhe vëllain e tij kanë mbajtur në Spitalin e Burgut Tiranë deri në vitin 2009 dhe më pas e kanë transferuar në Burgun e Zaharisë, në Krujë. Aktualisht, ai shprehet se vëllai tij vazhdon të qëndrojë në burgun e Zaharisë, në kundërshtim me vendimin e gjykatës, pa mjekim dhe në kushte shumë të rënda. Z.K. B kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi që, të zbatohet vendimi i gjykatës, i cili ka urdhëruar që vëllai i tij, të transferohet në ambjentet e

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Spitalit Psikiatrik Tiranë. Njëkohësisht, ai kërkon të dëmshpërblehet për dëmin shëndetësor të vëllait të tij, z.A. B.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Së pari, lidhur me pretendimet e z.K. B që të zbatohet vendimi i gjykatës, i cili ka urdhëruar që z.A. B, të transferohet në ambjentet e Spitalit Psikiatrik Tiranë, Komisioneri informon z.K. B, se ekzekutimi i vendimeve të gjykatës nuk bën pjesë në kompetencat e Tij.

Neni 462 i Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar, “Vendimet e ekzekutueshme”, në pikën 2 dhe 4 të tij parashikon se: “...2.**Vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes. 4. Mënyra e ekzekutimit të vendimeve penale rregullohet me ligj të veçantë”.**

Neni 470 i këtij Kodi “Gjykata kompetente për ekzekutimin” parcakon se: “**1.Gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij.**”.

Së dyti, lidhur me pretendimin për dëmshpërblim monetar, ardhur si pasojë e dëmtimit të shëndetit të z.A. B, Komisioneri nuk ka kompetencë të dëmshpërblejë individët, por dëmshpërblimi mund të kërkohej gjyqësisht.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Bazuar në nenin 33, pika 4/b/ç, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: “*Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”, nuk përmbushen kriteret e përcaktuara nga ky Ligj, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 2, si dhe në nenin 33, pika 4/b/ç, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së z.K. B, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha: Shërbime

Shakaku: Gjendja shëndetësore